

Mars 2018 / Shqip

(Albanisch)

CYRIHU PËR JU

BROSHURË INFORMATIVE E QYTETIT TË CYRIHUT PËR BANORËT E RI

Mirë se vini në Cyrih!

Ne jemi të lumtur që ju po vendoseni në qytetin tonë. Për lehtësimin e vendosjes tuaj në Cyrih, ne i kemi përmbledhur për ju disa informacione të rëndësishme si dhe shërbimet e qytetit..

- Në kapitullin **portreti i qytetit** ju prezantojmë qytetin..Ju merrni informacione mbi Cyrihun si dhe një shikim në historinë dhe politikën e qytetit.
- Në kapitullin **informacione të dobishme** ju gjeni adresa të rëndësishme, rreth jetës së përditshme në Cyrih si dhe link-e të vazhdueshme për faqë të internetit kryesisht në gjermanisht ose (nëse në dispozicion) për informacione në gjuhën shqipe.

Vendbanimi i juaj i ri Cyrihu, ju ofron një mjedis ideal për një cilësi të lartë të jetës. Vendndodhja pranë liqenit, popullsia e hapur ndaj botës dhe dinamika ekonomike, mund të bëjnë Cyrihun edhe për ju një qytet në të cilin mund të ndjeheni shpejt si në shtëpi, të cilën e gëzoni dhe për të cilin ndoshta keni dëshirë të angazhoheni.

Lenë ky publikim një pyetje të papërgjigjur ose doni ju një bisedë personale të informimit? Atëherë vizitoni tryezën mikëpritëse ([Welcome Desk](#)) në ndërtesën e administratës së qytetit (Stadthaus). Ajo është e hapur nga e hëna deri të enjten nga ora 14 deri në orën 18, shërbimet e saj janë falas.

I Portreti i qytetit

1. Metropoli në gjelbërim

Cyrihu është kryeqytet i kantonit me të njejtin emër, si dhe qyteti më i madh i Zvicrës. Si qendër e një hapësire metropoli, e cila përfshinë mbi 200 komuna, është qytet kombëtar dhe ndërkombëtar i rëndësishëm. Në Cyrih jetojnë mbi 420'000 njerëz; pothuajse më shumë se një e treta e popullsisë banuese janë qytetarë të huaj. Përafërsisht 15'000 njerëz nga bota e jashtme vendosen çdo vit në qytet.

Cyrihu është i rrethuar nga kodra të pyllëzuara dhe shtrihet direkt pranë liqenit të Cyrihut si dhe lumenjëve Limmat dhe Sihl. Qyteti i vjetër në qendër, banesat historike dhe pjesë të reja të qytetit në ripërdorimin e ish-zonave industriale, i japin qytetit një strukturë të shumanshme. Cyrihu është kompakt dhe i qartë, me distanca të shkurtra. Prandaj shumë qytetar lëvizin nëpër qytet çdo ditë, në këmbë, me biçikletë ose me mjete të qarkullimit publik.

Cyrihu është i kujdesshëm rreth burimeve natyrore dhe e ka fiksuar synimin e qëndrueshmërisë në kushtetut. Në Cyrih i ipet shumë rëndësi kualitetit të ndërtimit, rrugëve, shesheve si dhe zonave të gjelbërimit dhe natyres. Popullsia, kur mirret në pyetje rregullisht, shprehet shumë pozitivisht për qytetin e tyre. Ata ndjehen të rehatshëm dhe të sigurt. Edhe në rënditjen e qyteteve ndërkombëtare, Cyrihu zë gjithëherë pozitën më të lartë.

2. Shumëllojshmëria dhe pluraliteti

Në Cyrih jetojnë njerëz prej rreth 170 kombeve. Shumëllojshmëria e popullatës dhe stilet e jetesës ndikojnë në qytetin si dhe në të ardhmen do të kujdesën që Cyrihu vazhdimisht të ndryshoj. Ky kuptim pluralist i shoqërisë në Cyrih bazohet në bazat e shtetit juridik, në demokraci, solidaritet dhe të drejtën individuale të lirisë.

Banorët e ri janë në Cyrih të mirë se ardhur. Me një qëndrim të hapur ndaj botës, kushte të mira të jetesës dhe punës si dhe një politikë aktive të integritimit, qyteti krijon kushte paraprake që të gjithë të ndjehen përkatës në Cyrih. Njerëzit që banojnë këtu posedojnë mbi referime të ndryshme kulturore, fetare dhe sociale. Heterogjiniteti shoqëror formon imazhin urban dhe krijon një pjesë të rëndësishme të burimeve dhe forcave të Cyrihut.

3. Kulturë e gjallë – dhe qytet argëtimi

Ofertat e gjëra kulturore dhe të kohës së lirë në Cyrih kanë një rrezatim mbarë rajonal dhe ngreh shumë mysafirë. Ata përfitojnë nga shumëllojshmëria e mundësive të blerjes dhe ofertave të shumta të argëtimit. Më shumë se 2000 restaurante, kinema me filma në gjuhën origjinale dhe jetë të natës tërheqëse e bëjnë Cyrihun qytet argëtimi të pëlqyer.

Çdo ditë mbahen në qytet 70 shfaqje të degëve të ndryshme kulturore. Me teatrin, shtëpinë e artit, operën, sallën e koncerteve dhe me muzeun „Rietberg“ posedon qyteti mbi institucione kulturore të shquara ndërkombëtarisht. Skena të tjera për teatër dhe vallëzim, klube të shumta të muzikës, qendra alternative të kulturës dhe galeri të artit të rëndësishme i plotësojnë ofertat. Qyteti i nxitë artistat dhe krijimtarinë kulturore.

4. Ekonomia dhe Shkenca

Cyrihu është një vend i rëndësishëm ekonomik dhe vend i njohur i dijes dhe hulumtimit për ndërmarrje dhe njerëz nga mbarë bota. Qyteti është gjithashtu edhe një vend ndërkombëtar i rëndësishëm i financave. Ndërmarrje të suksesshme e begatojnë qytetin, dhe kujdesën që Cyrihu të angazhohet për më shumë kualitet të jetesës dhe lidhjen e brendshme sociale. Cyrihu nga ana tjetër nxitë degë premtuese si të ekonomisë kreative dhe kontribon në këtë menyrë në zgjerimin e ekonomisë.

Niveli i arsimit në Cyrih është i lartë – falë shkollave fillore të shkëlqyera, instituteve të larta profesionale dhe dy shkollave të njohura ndërkombëtarisht të larta, të universiteteve të Cyrihut dhe të shkollës së lartë teknike konfederale (ETH Cyrih). Në shkollat e larta studiojnë përafërsisht 50'000 njerëz; në më shumë se 50 institucione hulumtuese punojnë shumë shkencëtarë dhe shkencëtar me kualifikim të lartë.

5. 6000 vite histori

Para rreth 6000 viteve u krijuan vendbanimet e para me shtëpi mbi hunj në buzë të liqenit; ato janë zëvendësuar para rreth 4000 viteve prej vendosjeve përreth kodrave. Rreth 15 para krishtit lindi në Lindenhof baza ushtarake romake «Turicum», nga cili emër latin në vazhdim u bë Cyrih.

Në mesjetën e hershme dhe të mesme qyteti ka qenë i ndikuar nga kishat, zyrtare formale e qytetit ka qenë e para e murgeshave të Fraumünsters. Me revolucionin esnaf të 1336 fillojë dominimi i mjeshtëreve. Qyteti ju bashkangjiti 1351 konfederatës dhe krijoi një territor, që përafërsisht i ngjanë kantonit të sotëm të Cyrihut.

Me reformimin e Ulrich Zwinglis filloj 1519 një epokë e re – qyteti me anë të reformimit arriti domethënie evropiane. Megjithatë ekonomia e Cyrihut ngeci, deri në shekullin e 16 dhe 17, ku imigrantët fetar si hugenotët të cilët e ringjallën industrinë dhe tregtinë.

Në shekullin e 19 të vonshëm Cyrihu u zhvillua shumë: 1893 janë bashkuar njëmbëdhjetë komuna fqinjë me qytetin. 1934 ju bashkangjiten edhe njëherë tetë komuna. Gjatë dy luftërave botërore mbetën Zvicra dhe Cyrihu të kursyera; në të dy luftërat Cyrihu u bë qendër e jetesës për imigrantët politik.

Në hov të viteve të pas luftës e forcoj qyteti domethënjen e tij ekonomike, veçanërisht në sektorin e shërbimeve dhe si vend i financave. Aeroporti i afërt i Cyrihut Kloten dhe ndërtimi i trenave të shpejtë rajonal (S-Bahn) i krijojnë lehtësira zhvillimit të vendit metropolit Cyrihut me qytetin si qendër.

6. Politikë për të gjithë dhe me të gjithë

Çdo katër vite votojnë mosha madhore e qytetarëve të Cyrihut me pasaportë Zvicërane, parlamentin dhe qeverinë e tyre. Parlamenti komunal, këshilli i komunës përbëhet prej 125 anëtarëve dhe është instuticioni zyrtar ligjëvënës. Qeveria e qytetit quhet këshilli i qytetit dhe përbëhet nga nëntë veta, secili prej tyre e drejton një departament të qeverisë. Ata me të drejtë votimi nuk ftohen vetëm për zgjedhje por edhe rreth katër herë në vit për votime në urnë. Atëherë vendosin ata mbi çështje si për shembull mbi projekte dhe plane të qytetit.

E drejta e bashkëvendosjës ([Mitsprache](#)) është në Cyrih e vetëkuptueshme, banorët e japin fjalën e tyre në zhvillimin e qytetit dhe lagjës së tyre. Edhe të huajt pa të drejtë vote e kanë në Cyrih një zë – këshillin e të huajve ([Ausländerinnen und Ausländerbeirat](#)). Si megafon i popullsisë së huaj, jep ai kundrejtë qytetit rekomandime dhe i dorëzon aplikimet në parlamentin komunal.

7. Cyrihu në numra

Popullsia banuese (01.2018)	423'368
Pjesa e banuar nga popullësia e huaj	32,4% (137'060)
Grupi më i madh i të huajve	Gjerman (33'788)
Grupi i dytë më i madh i të huajve	Italian (14'764)
Grupi i tretë më i madh i të huajve	Portogezë (8'100)
Punonjës në qytetin e Cyrihut (12.2017)	456'600
Punonjës që vej e vijn në qytet çdo ditë	rreth 230'000
Bujtje nga persona të huaj (2017)	3'194'598
Sipërfaqja përfshirë ujratë	91,9 km ²
prej tyre pyll	21,5 km ²
Pika më e lartë (Üetliberg Kulm)	871 l.m.d
Lartësia e sipërfaqës së liqenit	406 l.m.d

Të dhëna dhe informacione të tjera i gjeni në librin vjetor statistikor të qytetit Cyrih dhe në qytetit Cyrih: www.stadt-zuerich.ch/statistik.

II informacione të dobishme

1. Ditët dhe javët e para

Pas arritjes suaj në Cyrih ju duhet të mendoni në disa gjëra, që qëndrimi juaj të jetë nga fillimi i rregulluar. Për shembull ndërrimin e adresës juaj duhet të ja lajmëroni zyrave dhe lidhjeve të biznesëve të shumta dhe të nxjerrni librezë të reja.

Ju lutemi para së gjithash të merni parasysh këto pika:

- Banorët e ri duhen brenda katërmbëdhjetë ditëve të regjistrohen në zyrën e qarkut ([Kreisbüro](#)) të lagjës së tyre. Në vijim gjërat që duhet t'i sjellni për regjistrim:
 1. Pasaporta ose letërnjoftimi (për Zvicëran çertifikata e vendbanimit)
 2. Letërnjoftimi i të huajve (në qoftë se ekziston)
 3. Sigurimin për leje qëndrimi (në qoftë se ekziston)
 4. Taksat për regjistrim (ndryshon nga prejardhja, max CHF 120.-)
- Sigurimi shëndetësor ([Krankenversicherung](#)) është obligativ; kush merr vendbanim në Zvicër duhet atë mbrenda tre muajve pas regjistrimit ta bëjë.
- Në Zvicër ekziston detyrimi shkollor. Fëmijët në moshën 4 deri 15 vite duhen të regjistrohen në qarkun e drejtorisë arsimore ([Kreisschulpflege](#)) të lagjës së tyre.

Gjuha e folur në Cyrih është dialekti zvicëran gjermanofon. Në komunikimin me shkrim përdoret në gjithë zvicrën gjermane gjermanishtja standarde, për t'u kuptuar në jetën e përditshme, njohuritë e gjermanishtës janë të domosdoshme. Përkrahja e integritit të qytetit Cyrih ofron një konsultore të kurseve gjermane ([Deutschkursberatung](#)); Ajo i njeh ofertat e përgjithshme të kurseve gjermane ([Deutschkurse](#)) në qytetin Cyrih dhe mund të ju ndërmjetësojë kursin që ju përshtatët.

Banorët e ri ftohen në takim të përshëndetjes ([Begrüßungsveranstaltung](#)) dhe informohen për organizime të tjera të përkrahjes së integritit dhe kurseve. Tryeza mikëpritëse ([Welcome Desk](#)) në ndërtesën e administratës së qytetit (Stadthaus) ofron veq kësaj një shumicë informatash mbi qytetin Cyrih dhe institucionet e tyre. Punëtorët e tryezës mikëpritëse (Welcome Desk) ju mbështesin në pyetje personale dhe pyetje ligjore, të cilat mund ju bëhen gjatë qëndrimit në Cyrih.

2. Jeta e përditshme

Në ditët e punës së përgjithshme, të hënën deri të premten janë zyrrat publike prej orës 8 deri 16:30 apo 17:00 të hapura. Shumica e dyqanave janë nga e hëna deri të premten rreth orës 09:00 – 20:00 të hapura. Dyqanet me të vogla shpesh mbyllën në orën 18:30. Koha e hapjes të shtunëve është kryesisht rreth orës 09:00-17. Në stacionin kryesor janë dyqynet edhe të dielën të hapura.

Qytetarët e Cyrihut janë në shumë lloje mobil. Dy e treta e popullsisë ecin në këmbë, me biçikletë ose i përdorin mjetet e qarkullimit publik. Qarkullimi publik ([öffentlicher](#)

[Verkehr](#)) në Cyrih ofron një rrjetë trafiku të besueshëm me oferta të dendura, që qytetin e lidh edhe me rajone të tjera.

Nëse vini me makinë në Cyrih , ju lutem vini re rregullat për zonën blu ([blauen Zonen](#)) si dhe për kartën e parkimit për banorët lokalë ([Anwohnerparkkarten](#)). Për përshkrimin e patentës si dhe për pyetjet rreth importit të automjetëve është zyra e trafikut rrugor e kantonit Cyrih përgjegjëse ([Strassenverkehrsamt Kanton Zürich](#)).

Transporti i plehërave mbledh rregullisht plehërat shtëpiake nëpër lagje. Kalandari i plehërave ([Entsorgungskalender](#)) si dhe një App falas Cyrih ([App Sauberes Zürich](#)) i pastërt jep informacione mbi atë. Transporti i plehërave është i taksuar; taksa mbledhet me blerjen e thasëve të bardhë „Züri-Säcke“, që mund të blihen në shitoren e mallrave ose të shitësit me pakicë. Thasët e plehërave duhen deri më së voni në orën 7 në ditën e transportimit të jenë të deponuara në kontinier. Kalandari i plehërave përmban edhe informacione mbi mbledhjen dy javore të letrave, të vendeve të mbledhjes së mbeturinave të xhamit dhe metalëve.

3. Puna

Për banorët e EU-EFTA vlenë plotësisht lëvizja e lirë e personave ([Personenfreizügigkeit](#)). Marrvëshja nuk e parasheh një tranzicion automatik por atë gradual në lëvizjen e lirë të punëmarrsit dhe të pavarurit. Prandaj mund të jetë hyrja në tregun e punës (ende) i kufizuar [në varësi të shtetis](#) . Ju duheni para fillimit të punës të regjistrohëni në zyrën e Qarkut ([Kreisbüro](#)) për rregullimin e lejeqëndrimit.

Shtetasit që nuk janë nga një shtet i EU-EFTA njihen si shtetas nga vende të ndërmjetem dhe për punësim ju duhet një leje e punës ([Arbeitsbewilligung](#)). Vetëm pas dhënjes të lejës mund të filloni punësimin. Përgjigje dhe pyetje për këtë procedon e kërkesës ju i gjëni këtu ([hier](#))

Vende të lira të punës janë zakonisht të reklamuar në internet ose në shtypin lokal apo kombëtar. Konsultorja e Profesionit dhe Karrierës ([Berufs- und Laufbahnberatung](#)) si dhe Qendrat e ndërmjetimit të punës RAV ([Regionale Arbeitsvermittlungszentren RAV](#)) të qytetit Cyrih ju mbështesin në fillimin e hyrjes në punë.

Vlen të njihën informacione mbi hyrjen në profesion ([Informationen zum Berufseinstieg](#)) për njerëz të cillët janë në Cyrih në kontekstin e bashkimit familjar apo të një partneriteti, janë të postuara në faqën e internetit të përkrahjes për integrim. Këtu ju mund të gjëni gjithashtu informacione për njohjen e diplomave të huaja.

Nëse keni pyetje për ligjin e punës ju mund të keshilloheni personalisht tek gjyqi punës ([Arbeitsgericht](#)) apo të informoheni tek tryeza mikëpritëse për një vend këshillimi të përshtatshëm

4. Banimi

Pjesa më e madhe e pronësis së banesave dhe shtëpive në Cyrih është pronë private. Në krahasim me qytete tjera ka megjithatë oferta të konsiderueshme të banesave me dobi publike ([gemeinnützige Wohnungen](#)) për njerëzit me të ardhura të ndryshme. Pronësia individuale e banesave nuk është e zakonshme në Zvicër, shumica e njerëzve banojnë në banesë me qira.

Edhe pse akoma ndërtohen shumë banesa, tregu i banesave në Cyrih është i tendosur, kush e kërkon një banesë duhet t'i përdorë të gjitha mundësitë e kërkimit ([Suchmöglichkeiten](#)).

Banimi i përbashkët nën një kulm është me kërkesa të larta dhe mund të vijë në keqkuptime ose konflikte të shmangshme. Për atë është i rregulluar me rregulla shtëpiake. Mbi rregullat shtëpiake ([Hausregeln](#)) informon në shumë vende një pllakatë në shumë gjuhë që është e ngjitur në hyrje të shtëpisë.

5. Shëndeti

Qyteti i Cyrihut posedon një sistem të shkëlqyer të shëndetit me mjekte dhe mjek praktikues, spitale urbane ([städtische Spitäler](#)), spitalin universitar ([Universitätsspital](#)), shërbimet komunale shëndetësore ([Städtische Gesundheitsdienste](#)) dhe një sistem të dendur të shërbimeve parandaluese dhe të përkujdesjes.

Sistemi shëndetësor i Zvicrës mbështetët kryesisht në Klinikat e mjekëve të shtëpisë ([Hausarztpraxen](#)). Mjekët dhe mjeket e përgjithshme në rrethin e banimit janë në raste emergjente kontakte të rëndësishme; ata janë zakonisht shpejt në dispozicion. Në shumë klinika të mjekëve posedojnë punëtorët e klinikës mbi njohuri gjuhësore ([Sprachkenntnisse](#)) të shumta. Edhe Barnatoret me punëtor disagjuhësh ([Apotheken mit mehrsprachigem Personal](#)) ofrojnë informacione mbi kujdesin primar shëndetësor. Për kujdesin shëndetësor të fëmijëve ka pediatri të specialisuara ([Kinderarztpraxen](#)).

Sigurimi obligativ i shëndetësis ([obligatorische Krankenversicherung](#)) financon një kujdes të plotë mjekësor. Personat me të ardhura të ulëta kanë mundësinë në këto kushte të përfitojn nga pagesat më të lira të sigurimit. Departamenti i shëndetësisë dhe mjedisit të qytetit Cyrih ju dërgon të gjithë banorëve të ri një shkrim informimi dhe ofron fletë udhëzuese ([Merkblätter](#)) në gjuhën gjermane mbi sigurimin shëndetësor dhe lirimin e pagesës ([Prämienverbilligung](#)).

6. Fëmijët dhe rinia

Fëmijëve dhe të rinjve ju ofron qendra e bashkësis dhe e lagjës ([Gemeinschafts- und Quartierzentren](#)) (shih pikën 9) vende të takimit si dhe shumë mundësi për aktivitete të lira. Shpesh janë në qendra edhe vendët këshilluese për nëna dhe baballarë ([Mütter- und Väterberatungsstellen](#)) të vendosura, të cilat i mbështesin prindërit dhe fëmijët e tyre në çfarë do pyetje.

Në Cyrih ekzistojnë lloje të ndryshme të kujdesit të jashtëm familjar për fëmijët në moshën parashkollorë: Kopshti ([Kinderkrippen](#)), prindërit ditor ([Tageseltern](#)), ose grupe loje ([Spielgruppen](#)) kujdesën për fëmijët gjatë disa orëve ose ditës.

Është e dobishme që të informoheni me kohë rreth vendëve të kujdesjes ([Betreuungsplätze](#)). Qyteti Cyrih [subvencionon](#) vende kopshti dhe ofrime të strehëve të fëmijëve (shih poshtë).

7. Shkolla

Të gjithë fëmijët në Cyrih shkojnë për më së paku njëmbëdhjetë vjet në shkollë, prej kopshtit të detyrueshëm deri te shkolla e mesme. Hyrja në kopsht fillon me katër vite dhe mund të plotësohet me një kujdesje jashtë familjare në strehimoret ditore ([Horte](#)).

Strehimet ditore për fëmijë janë vende të cilat ofrojnë përkujdesje profesionale për fëmijë kopshtesh dhe shkollash. Fëmijët dhe personat që përkujdesen për ta e organizojnë kohën pas shkollës, zakonisht në grupe me rreth njëzet fëmijë të moshave të ndryshme. Përkujdesja mund të jetë gjithëditore, nga e hëna deri në të premten, ose në ditë të veçanta si dhe sipas zgjedhjes: mëngjeseve, drekave apo mbasditeve.

Fëmijët regjistrohen në Qarkun e drejtorisë arsimore ([Kreisschulpflege](#)) në lagje për shkollë ose kopsht. Shkolla publike ([Volksschule](#)) është falas, ndihmesa e prindërve ([Mitwirkung der Eltern](#)) është e mirë se ardhur. Në dosjen e gjuhës ([«Sprachmappe»](#)) janë informatat më të rëndësishme rreth sistemit arsimor në dhjetë gjuhë të përmbledhura. Të gjithat që vlen të njihen nga qerdhja deri në shkollën e mesme mund ti gjeni tematikisht të rënditura dhe të ndara në dhjetë Kapitull.

8. Partneriteti dhe familja

Në secilën fazë të jetës ekzistojnë ngjarje familjare dhe private, që bien me vete detyrimin e lajmërimit. Në zyrën e gjendjes civile ([Zivilstandesamt](#)) duhet lindjet të lajmërohen, bëhet caktimi për datat e martesës dhe regjistrimi i partneritetit. Zyra e varrimit dhe varrezave ([Bestattungs- und Friedhofamt](#)) ofron të gjitha shërbimet në lidhje me varrimin e një personi të vdekur.

Qendrat sociale ([Sozialzentren](#)) të qytetit Cyrih këshillojnë dhe i mbështesin familjet në pyetjet sociale dhe ekonomike. Pyetjeve për bashkim familjar ju përgjigjet tryeza mikpritëse ([Welcome Desk](#)) e qytetit Cyrih dhe këshilla ligjore MIRSAH ([Rechtsberatung MIRSAH](#)). Qendra e këshillimit [Infodona](#) ofron këshillime në gjuhën amtare në pyetje dhe probleme në temat rreth familjes, drejtësisë, financave dhe shëndetsisë. Infodona gjithashtu ofron ndihmë në përbalimin e detyrave administrative.

9. Koha e lirë dhe shoqatat

Në shumë lagje të qytetit ndodhën qendra të bashkësis dhe të lagjës ([Gemeinschafts- oder Quartierzentren](#)) me vende të lojës, oferta të organizimeve për të gjitha gjeneratat. Bibliotekat Pestalozzi ([Pestalozzibibliotheken](#)) ofrojnë në gjithë qytetin një ofertë të gjërë të mediave në gjuhë të ndryshme për fëmijë ([Medienangebot in verschiedenen Sprachen](#)), të rinjë dhe të rritur. Zyra e sporteve ([Sportamt](#)) ofron komplekse të shumta sportive dhe i nxitë aktivitetet sportive ([Breitensport](#)). Puna vullnetare në nivelin lokal ndërmjetësohet përmes [Kontaktstelle Freiwilligenarbeit](#) ose ndihma për fqinjë ([Nachbarschaftshilfe](#)).

Shumë aktivitete shoqërore organizohen në Zvicër prej shoqatave ([Vereine](#)) Edhe organizimet e migrantëve ([Migrantenorganisationen](#)) dhe bashkësive fetare ([religiöse Gemeinschaften](#)) kanë në rregull formën e shoqatave. Informacione të tjera dhe adresa i gjeni në tryezën mikëpritëse ([Welcome Desk](#)).

10. Sistemi i taksave

Sistemi i taksave në Zvicër ndahet në taksa federale ([Bundessteuer](#)) si dhe taksat e kantonit dhe komunës ([Kantons- und Gemeindesteuer](#)). Çdo person që jeton dhe punon në Zvicër është i taksueshëm dhe duhen çdo vitë të mbushin deklaratën e

taksave. Në atë i deklaroni ju pagat e fituara dhe pasuritë. Detyrimi tatimor në kantonin dhe qytetin e Cyrihut fillon prej marrjes së vendbanimit.

Puntorët e huaj në Cyrih, që nuk e posedojnë leje qëndrimin ose nuk janë të martuar me një person që e posedon shtetësinë apo leje qëndrimin, janë të taksueshëm në burim. Taksa në burim ([Quellensteuer](#)) zbritet direkt nga paga.

11. Sigurimet

Sigurimet sociale ([Sozialversicherungen](#)) në Zvicër janë obligative dhe e sigurojnë ekzistencën ekonomike. Ato janë të ndara në pesë lëmi:

- Sigurimi i pensionit të moshës-, trashigëmisë – dhe invalide (AHV/IV)
- Sigurimi i shëndetsisë dhe aksidenteve,
- Kompensimi i të ardhurave për shërbimet e ofruara dhe të amësisë (EO),
- Sigurimi i papunësisë (ALV) si dhe
- Shtesa për familje.

Me përjashtim të sigurimeve të shëndetsisë (shih pikën 1 dhe 5) i zbresin sigurimet tjera kontributet direkt nga rroga. Nuk është nga ligji e udhëzuar, por është shumë e rekomandueshme të bëni një sigurim të shtëpisë dhe sigurimin privat të dëmshpërblimit ([Hausrat- und Privathaftpflichtversicherung](#)). Përkrahja për integrim e ka postuar një broshurë përmbledhëse ([zusammenfassende Broschüre](#)) në faqën e internetit.

12. Numrat e urgjencës

Zjarrfikësat	118
Policia	117
Ndihma e shpejtë/Ambulanca	144
Shërbimi emergjent mjekësor, telefoni i mjekëve	0800 33 66 55
Qendra toksikologjike informacioni i helmeve	145
Shtëpia e grave Violetta	044 350 04 04
Emergjencia për prindër	0848 35 45 55
Emergjencia për fëmijë – dhe të rinjë	147